

**VENDIM**  
**Nr. 158, datë 29.10.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ARSTI”  
SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “ARSTI”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC ARSTI” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 8/4 prot, datë 23.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC ARSTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria HEC ARSTI sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 600 prot, datë 26.9.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arsti”.

- Aplikimi i shoqërisë “HEC ARSTI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Shoqëria HEC ARSTI sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata e koncesionit.

- Kontrata e Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC Arsti”, është lidhur midis Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) HEC ARSTI sh.p.k. në cilësinë e Koncesionarit dhe MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Me Kontratën shtesë të Koncesionit nr. 2785 rep. dhe nr. 1308/3 kol, datë 14.12.2017, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, të formës BOT “Për ndërtimin e HEC Arsti”, të lidhur midis SPV “HEC ARSTI” sh.p.k dhe MIE, është ndryshuar afati për pajisjen me lejet e nevojshme, i cili nga 12 muaj, është bërë, jo më shumë se 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit”.

- Në analizë të sa më sipër rezulton se:

- Sipas Kontratës së Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC Arsti”, janë parashikuar vetëm dy vepra marrje me kapacitet të instaluar 3130 MW.

- Sipas Projektit të zbatimit për të cilin është kryer dhe Oponenca Teknike e AKBN nr. 1943/4 prot, datë 27.4.2017, janë parashikuar tre vepra marrje me kapacitet të instaluar 3410 MW.

- Rezulton se shoqëria nuk ka depozituar në ERE kontratë shtesë koncesioni që të pasqyrojë ndryshimin e parametreve.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). Mungon vërtetimi i Gjykatës për administratorin e saj, për të deleguarin përgjegjës dhe për vetë shoqërinë, si dhe vërtetimin e prokurorisë për vetë shoqërinë dhe për të deleguarin përgjegjës.

- Neni 9, pika 2, germa “f” (Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Nuk rezulton të jetë depozituar në ERE kontratë shtesë Koncesioni për parametrat e ndryshuar të pasqyruar më sipër sipas projektit të zbatimit dhe rekomandimit të Oponencës Teknike, për pasqyrimin e tyre në një kontratë shtesë koncesioni.

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria ka depozituar në ERE bilancet të shoqërive ortake pa dhënë shpjegime lidhur me këtë pikë.

- Neni 9, pika 2, germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).

- Shoqëria “HEC ARSTI” sh.p.k. ka depozituar Certifikatat për Vërtetim Pronësie të lëshuar nga ZVRPP Pukë, në datën 30.5.2019, për numrat e pasurive 233/1, 234/1, 235/1, 236/1, 237/1, 238/1, në zonën kadastrale 1054, në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga përmbajtja e së cilës rezulton se në datën 7.9.2019 është bërë regjistrimi i Kontratës së Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC Arsti”, të lidhur midis SPV “HEC ARSTI” sh.p.k. dhe MIE.

- Vendimin nr. 57, datë 25.4.2018, të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, “Për dhënien e pëlqimit për dhënien në përdorim të sipërfaqes fond pyjor kullësor në administrim të bashkisë Fushë-Arrëz në zonën kadastrale nr. 1619, me sipërfaqe 3.7728 ha, njësia Administrative Fierzë, në funksion të ndërtimit të HEC ARSTI nga shoqëria HEC ARSTI sh.p.k.”.

- Është depozituar aneksi nr. 1, në të cilin pasqyrohet lista e ngastrave që jepen në përdorim/qira për shoqërinë HEC ARSTI sh.p.k., për ndërtimin e HEC-it ARSTI. Ky aneks, është e paqartë se më cilën kontratë qiraje lidhet.

- Dokumentacioni teknik për HEC.

Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

Nga ana e shoqërisë është deklaruar një kapacitet i transformatorit të fuqisë prej 1.8 MWA i cili është më i ulët se kapaciteti i instaluar i HEC-it.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “c” dhe “e”.

Shoqëria ka paraqitur në ERE Raportin e Oponencës Teknike të kryer nga AKBN mbi projektin e zbatimit të “HEC Arsti” dërguar në MIE me shkresën nr. 1943/4 prot, datë 27.4.2017. Oponencë e cila daton pas nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC Arsti”, të lidhur midis SPV HEC ARSTI sh.p.k. dhe MIE. Kjo Oponencë që ka depozituar shoqëria në ERE, nuk rezulton të ketë marrë miratimin nga MIE të Projektit të Zbatimit apo të jetë shoqëruar me nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit, sipas rekomandimit të AKBN-së.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8,

të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE, duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës, për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC ARSTI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arsti”, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM  
ANËTARE BORDI  
**Erjola Sadushi**